



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2020:189183
Datë: 25.04.2024
Numri i dokumentit: 05617876

E.nr.521/23

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtarin Faton Ajvazi dhe sekretaren juridike Makfire Reçica, duke vendosur në çështjen juridike përmbartimore të kreditorëve: Sh.M., Sh.A.1., Sh.A.2., S.M. dhe N.E., të gjithë nga Shtimja, të cilët i përfaqëson av Labinot Buzuku nga Prishtina, kundër debitorit Komuna e Shtimes – Drejtoria e Arsimit, për pagesën e shpenzimeve të ushqimit, udhëtimit, shpërblimit jubilar dhe shpenzimet e procedurës, më datë 25.04.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

PËRFUNDON procedura përmbartimore në lëndën **E.nr.521/23**, për shkak të përmbushjes së kërkesës së kreditorëve.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Ferizaj, me aktvendimin E.nr.521/23, të datës 22.03.2023, e ka caktuar përmbartimin e propozuar nga i autorizuari i kreditorëve, kundër debitorit Komuna e Shtimes – Drejtoria e Arsimit, për pagesën e shpenzimeve të ushqimit, udhëtimit, shpërblimit jubilar dhe shpenzimeve të procedurës, në bazë të pajtimit gjyqësor 2020:189183, të datës 07.12.2022.

Meqenëse aktvendimi mbi lejimin e përmbartimit është bërë i formës së prerë dhe i ekzekutueshëm, gjykata me aktvendimin e datës 21.09.2023, e ka urdhëruar Thesarin e Kosovës pranë Ministrisë së Financave, Punës dhe të Transfereve, që nga llogaria e debitorit ta transferoj shumën e përgjithshme të mjeteve prej 6,463.50 euro, në llogarinë e të autorizuarit të kreditorëve.

Meqenëse kreditorët e kanë realizuar kërkesën e tyre, Gjykata konstatoj se janë përmbushur kushtet ligjore nga neni 66, par 4, të LPP-së, dhe vendosi që ta përfundoj procedurën përmbartimore në këtë çështje juridike përmbartimore.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
E.nr.521/23, më datë 25.04.2024

GJYQTARI
Faton Ajvazi